



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Komiteti Shqiptar të Helsinkit publikon raportin final të monitorimeve në Komisaritet e Policisë, Paraburgime dhe Burgje për vitin 2014

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), pas një raundi gati një vjeçar monitorimesh në komisaritet e policisë, paraburgime dhe burgje, si dhe pas realizimit të një tryeze të rrumbullakët për prezantimin paraprak të draftit të parë të raportit të monitorimeve, publikon raportin final të këtyre vëzhgimeve.

Raporti paraqet gjetjet kryesore të vërejtura në institucionet të privimit të lirisë të monitoruara, duke u fokusuar kryesisht në trajtimin e grupeve në pozita të dobëta në burgje, në mënyrë më specifike në trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të miturit, gratë dhe gjithashtu për çështje të tjera të rëndësishme shqetësuese. Raporti u paraqet autoriteteve shtetërore rreth 54 sugjerime për gjetjet përkatëse, në mënyrë që të përmirësohet situata në institucionet e vëzhguara.

Ky publikim i është shpërndarë të gjitha institucioneve relevante shtetërore, aktorëve ndërkombëtarë, organizatave të shoqërisë civile si dhe bibliotekave të disa fakulteteve (fakultetit juridik dhe atij të shkencave sociale).

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinki në partneritet me Civil Rights Defenders dhe mbështetet financiarisht nga Swedish International Development Cooperation Agency, si dhe në kuadër të projektit “Së bashku për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria”, financuar nga Bashkimi Evropian.



Financed by the European Union



Civil Right Defenders



Komiteti Shqiptar i Helsinkit